



Prishtinë: 23.06.2016

Kodi i ZRRE-së: V_829_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët;
- Rekomandimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_1481_05_16**;

në seancën e mbajtur më datë 23.06.2016, nxori këtë:

V E N D I M

I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A. B. (Sh. A. Sh.A) nga Kamenica me shifër DGL – 9021400, që KEDS-i të investoj në rrjetin elektrik sipas kushteve teknike të parapara në Pëlqimin Elektroenergjetik nr. nr.3904 të datës 22.05.2015.

Arsyetim

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 03.06.2015 është parashtruar ankesa nga konsumatori A. B. “Sh.. A. SH.A” nga Kamenica me shifër DGL – 9021400 lidhur me plotësimin e kushteve teknike të parapara në Pëlqimet Elektroenergjetike të lëshuara nga Opertori i Sistemit të Shpërndarjes.

Me datë 31.01.2006 Kompania Energjetike e Kosovës (KEK), Divizioni i Rrjetit në Gjilan ka lëshuar Aktvendimin për Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) nr.40 për konsumatorin A.. B, Kompania Sh. A. me kushtet teknike si më poshtë: Fuqia e njëkohshme e angazhuar e objektit të jetë 15 kW, objekti kyçet në nivelin e tensionit 10/04 kV, lloji i kyçjes është tre fazorë, kablo nëntokësorë 4x25 mm², si dhe kyçja do të bëhet në TS-Bujnovc.

Provë: Aktvendimi për Pëlqim Elektroenergjetik nr. 40 i datës 31.01.2006

Me datë 17.04.2008 KEK - Divizioni i Rrjetit bazuar në kërkesën e konsumatorit A. B., Kompania Sh. – A., ka lëshuar PEE-në nr. 2200 për konsumatorin me kushtet teknike të reja si më poshtë: Duke pasur parasysh që konsumatori bënë rritjen e fuqisë nga 15 kW në 50 kW atëherë konsumatori me mjetet e veta duhet të ndërtoj një TSS të ri me fuqi S=100 kVA, lidhja e TSS të ri të bëhet në LP ajror 20 kV nga dalja 10 kV “Hogosht” e TS 110/10 kV” Kamenica”, shtylla ku do te behet lidhja e LP të ri duhet të jet shtyllë betoni H=12 m, 40[®] me konzollë K-20 si dhe pajisjet e montuara duhet të jenë të reja.

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik nr. 2200 i datës 17.04.2008

Me datë 03.03.2014 Komuna e Kamenicës ka bërë kërkesë zyrtare në KEDS-Gjilan që bazuar në kërkesat e disa lokaliteteve të komunës së Kamenicës të bëhet inspektimi nga ana e KEDS-it mbi mundësit e përforcimit të rrjetit ekzistues, si dhe vendosjen e disa trafove te reja e që njëra prej tyre është edhe në fshatin Bujnovc –Fabrika e Ujit.



Provë: Kërkesa e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe të Ambientit të Komunës së Kamenicës nr.09/32 të datës 03.03.2014

Bazuar në kërkesën nr. 348 të datës 03.03.2014 të Komunës së Kamenicës për rekonstruktimin e rrjetit, si dhe ndërtimin e disa trafostacioneve, Divizioni i Shpërndarjes-Distrikti Gjilan për objektin e fabrikës së ujit "KIKA" ka dhënë këtë zgjidhje teknike. Në këtë zgjidhje teknike theksohet se bazuar në PEE nr. 2200 të datës 17.04.2008 duhet të ndërtohet LP ajror 10(20) kV nga dalja 10 kV "Hogosht" i cili furnizohet nga TS 110/10(20) kV" Berivojcë". Karakteristikat teknike duhet të jenë: TS duhet të jetë shtyllë metalike, 10(20)/0.4 kV me fuqi $S_n=100$ kVA.

Provë:Zgjidhja teknike sipas kërkesës nr. 348/14 e datës 17.06.2014

Me datë 22.05.2015, Divizioni i Rrjetit bazuar në kërkesën e konsumatorit A. B., Kompania Sh..A.. për vazhdimin e PPE-së nr. 2200 të datës 17.04.2008 ka bërë revidimin e PEE-së, si dhe ka vazhduar PEE-në nr.2200 duke bërë disa ndryshime në kushtet teknike të parapara me herët në PEE nr.2200, si dhe bazuar edhe në kërkesën e konsumatorit për rritjen e fuqisë.

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik nr. 2200 i reviduar me datë 22.05.2015

Me datë 16.05.2016 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit në ankesën e tij të parashtruar në KESCO mbi shërbimet e energjisë elektrike përkatësisht rrjetit të vjetruar, si dhe tensionit të ulët. Në përgjigjen e lëshuar nga KESCO evidentohet se konsumatori ka pëlqimet elektroenergjetike të lëshuara nga Divizioni i Rrjetit i KEDS-it me te gjitha kushtet teknike të parapara për kyçjen e objektit në rrjetin elektrik bazuar në kërkesat e konsumatorit për rritjen e fuqisë, por që asnjëra nga këto kushte nuk është e plotësuar.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 16.05.2016

I paknaqur me përgjigjen e KESCO-s konsumatori me datë 03.06.2016 ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO. Konsumatori në ankesën e tij ka kundërshtuar investimin e kërkuar nga KEDS për furnizim me energji elektrike të kompanisë së tij, me arsyetimin se rrjeti elektrik është pronë e KEDS-it dhe se të gjitha investimet duhet të rezlisohen nga Kompania e Shpërndarjes. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se KEDS është përgjegjës për operimin dhe zhvillimin e rrjetit elektrik dhe se në asnjë mënyrë nuk duhet të bëhet ky investim nga investitori dhe se asnjë nga kushtet e ofruara nga kompania nuk janë të pranueshme nga ai.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së e datës 03.06.2016

KEK - Divizioni i Rrjetit në Gjilan me datë 31.01.2006 ka lëshuar Aktvendimin për Pëlqimin Elektroenergjetik nr.40 për konsumatorin A. B., Kompania Sh.. – A.. me kushtet teknike si më poshtë: Fuqia e njëkohshme e angazhuar e objektit duhet te jetë 15 kW, objekti kyçet në nivelin e tensionit 10/04 kV, lloji i kyçjes është tre fazorë, kabllo nëntokësorë 4x25 mm² si dhe kyçja do te behet në TS-Bujnovc. Sipas të dhënave të evidentuara në Aktvendim konsumatori ka plotësuar kushtet teknike, si dhe ka bërë pagesën për PEE. Andaj bazuar në këtë dhe transaksionet e konsumatorit konstatohet se konsumatori në fjalë KEK-u me datë 14.02.2006 i ka hapur shifër DGL - 9021400 dhe se nga ajo periudhë vërehet se kemi shpenzim të energjisë elektrike, si dhe faturim të rregullt mujor. Vlen të theksohet nga shkresat e lëndës konsumatori është regjistruar si konsumatori i grupit tarifor 4 (7/02).

Provë: Aktvendimi për Pëlqim Elektroenergjetik nr. 40 i datës 31.01.2006 dhe transaksionet e konsumatorit

Pas kësaj konsumatori në fjalë ka bërë rritjen e fuqisë në objektin e tij dhe KEK Divizioni i Rrjetit bazuar në rritjen e kapacitetit nga ana e konsumatorit me datë 17.04.2008 ka lëshuar PEE-në të ri nr.2200 me kushte teknike të reja, e të paraqitura më poshtë e në të cilën theksohet: pasi që konsumatori ka bërë rritjen e fuqisë nga 15 kW në 50 kW, atëherë konsumatori me mjetet e veta duhet të ndërtoj një TS të ri me fuqi $S=100$ kVA, lidhja e TS të ri të bëhet në LP ajror 20 kV nga dalja 10 kV "Hogosht" e TS 110/10 kV" Kamenica", shtylla ku do të bëhet lidhja e LP të ri duhet të jetë



shtyllë betoni H=12 m, 40[®] me konzollë K-20, si dhe pajisjet e montuara duhet të jenë të reja. Po ashtu në PEE i është përcaktuar edhe mënyra e matjes së energjisë elektrike e që është njehsor elektrik gjysme indirekt (komplet grupi matës) i përberë nga matësi i energjisë aktive (kl 0.5) me tregues të fuqisë maksimale dhe me matës të energjisë reaktive, si dhe Transformatorët Matës Rrymor duhet të jenë të raportit 100/5A. Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga konsumatori konstatohet se i njëjti ka bërë pagesën e të gjitha shërbimeve të kërkuara me PEE-në 2200 në vlerë 1,184.5€.

Provë: Pëlqimi Elektroenergjetik nr. 2200 i datës 17.04.2008

Me datë 03.03.2014 Komuna e Kamenicës ka bërë kërkesë zyrtare në KEDS- Gjilan që bazuar në kërkesat e disa lokaliteteve të komunës së Kamenicës të bëhet inspektimi nga ana e KEDS-it mbi mundësitë e përforcimit të rrjetit ekzistues, si dhe vendosjen e disa trafove të reja e që njëra prej tyre është edhe në fshatin Bujnovc –Fabrika e Ujit. Bazuar në kërkesën nr.348 të datës 03.03.2014 të Komunës së Kamenicës për rekonstruktimin e rrjetit, si dhe ndërtimin e disa trafostacioneve Divizioni i Shpërndarjes, Distrikti Gjilan për objektin e fabrikës së ujit “KIKA” ka kthyer përgjigjën duke dhënë zgjidhjen teknike si më poshtë: bazuar në PEE-në nr.2200 të datës 17.04.2008 duhet ndërtuar LP ajror 10(20) kV për kyçjen e TS “shtyllë metalike” të re Sn=100kVA në daljen 10 kV “Hogosht” i cili furnizohet nga TS 110/10(20) kV” Berivojcë”. Karakteristikat teknike duhet të jenë: TS duhet të jetë shtyllë metalike, 10(20)/0.4 kV, Sn=100 kVA, LP ajror L=420 m, Pmax=2.394, humbjet teknike të daljes 10kV=8.11%, rëniet e tensionit të daljes 10kV te TS i ri=14.514% si dhe matja e energjisë duhet të bëhet me njehsor multi funksional TMRR=150/5A. Me datë 22.05.2015, Divizioni i Rrjetit bazuar në kërkesën e konsumatorit A. B., Kompania Sh. = A. për vazhdimin e PEE-së nr.2200 të datës 17.04.2008 ka bërë revidimin e PEE-së, si dhe ka vazhduar PEE-së nr.2200 duke bërë disa ndryshime në kushtet teknike të parapara me herët në PPE nr. 2200 bazuar edhe në kërkesën e konsumatorit për rritjen e fuqisë.

Provë: Zgjidhja teknike sipas kërkesës nr. 348/14 datë 17.06.2014 si dhe PPE nr. 2200 e reviduar me datë 22.05.2015

Konsumatori A. B. me shifër të konsumatorit DPR – 9021400 me datë 23.03.2015 ka parashtruar kërkesë në KEDS për ripërritjen e Pëlqimit Elektroenergjetik.

Provë: Kërkesa e konsumatorit e datës 23.03.2015

ZRRE ka analizuar të gjithë dokumentacionin e ofruar nga dy palët, KEK, KEDS dhe KESCO si dhe nga konsumatori dhe konstaton se Divizioni i Rrjetit në KEDS në të gjitha rastet ka kthyer përgjigje konsumatorit në kërkesat e konsumatorit për rritjen e fuqisë përmes PEE në të cilat është përcaktuar qartë detyrimet e konsumatorit me rastin e aplikimit për rritjen e kapacitetit duke përcaktuar kushtet teknike të kyçjes me të cilat, i njëjti do të ketë energji stabile konform standardeve të përcaktuara edhe në kodet teknike e të cilat do të plotësonin kushtet e operimit të objektit të konsumatorit, si dhe mos ngarkimin/dobësimin e rrjetit ekzistues që do të ndikonte edhe në kualitetin e furnizimit tek konsumatorët e tjerë. Sipas të dhënave të ofruara konsumatori përveç shërbimeve për fuqi dhe kyçje të paguara e të cilat rrjedhin nga PEE nr.2200 të datës 17.04.2008 nuk ka plotësuar asnjë nga kushtet teknike të kërkuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes me qëllim të furnizimit me energji elektrike sipas standardeve të parapara duke kundërshtuar investimin vetanak për përforcimin e rrjetit të kërkuar nga Rrjeti i Shpërndarjes.

Sa i përket pikës së ankesës së konsumatorit, se KEDS-i si pronar i aseteve në rrjetin elektrik duhet të bëjë vet investimin në rrjet, kjo nuk qëndron, pasi bazuar në Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrik neni 9 paragrafi 6 thuhet se: *“Asnjë pagesë nuk do bëhet për përforcim të një rrjeti ekzistues nëse kërkesa për ngarkesë të re ose të shtuar nuk kalon 3% të kapacitetit efektiv ekzistues në pikën përkatëse në rrjet”*, por që në rastin e konsumatorit duhet theksuar se kërkesa për rritjen e fuqisë është rritur nga vet konsumatori nga 15 kW në 60 kW, e që kjo paraqet rritje prej



300%. Duhet theksuar se nga trafostacioni ku furnizohet aktualisht konsumatori janë duke u furnizuar edhe disa konsumator tjerë, dhe se rrjeti ekzistues ku aktualisht është duke u furnizuar konsumatori nuk e përballon këtë rritje të kapacitetit, pa u bërë përforsim i rrjetit, si dhe konsumatori nuk ka leje për kapacitetin për të cilën është duke e ngarkuar rrjetin elektrik. Pra, sipas kësaj nënkuptohet se i njëjti duhet të bëjë përforsimin e rrjetit elektrike bazuar në kushtet teknike të ofruara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes në Pëlqimet Elektroenergetike.

Gjatë analizës së bërë PEE nr.2200 të datës 17.04.2008, Zgjidhjes teknike nr.348/14 të datës 17.06.2014, si dhe PEE nr.3904 të datës 22.05.2015 të lëshuara nga KEK dhe KEDS-i kemi konstatuar se kjo formë e kyçjes përcaktohet si kyçje e “thellë”. Sipas nenit 9, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 theksohet se: Për tu kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetin ekzistues, si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim në rastin kur kërkohet zgjerim ose përforsim në rrjetin e transmisionit ose shpërndarjes, atëherë kjo formë e kyçjes emërtohet si “kyçje e thellë”. Gjithashtu duhet theksuar se sipas nenit 3, paragrafi 1.2, të Parimeve të përcaktimit të ngarkesave për shpërndarje, “kyçje e thellë” nënkupton se parashtruesi i kërkesës me shpenzimet e veta ofron apo paguan direkt kostot e aseteve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të lidhjes në sistemin ekzistues të shpërndarjes plus çfarëdo kosto indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlidhura me përforsimin, zgjerimin apo ri-konfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat janë shkaktuar si pasojë direkte e krijimit të kyçjes. Pra sipas nenit të lartëcekur dhe nenit 9, paragrafi 6, i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, çdo konsumator i cili bënë rritje të kapacitetit më të lartë se 3% nga kapaciteti efektiv ekzistues atëherë nënkuptohet se kemi të bëjmë me kyçje të thellë dhe si i tillë konsumatori është i obliguar që për pjesën ku kërkohet të bëhet përforsimi, zgjerim apo rikonfigurimit i rrjetit duhet të bëjë investimet e duhura teknike ashtu që të mund të furnizohet me energjisë elektrike në mënyrë të vazhdueshme dhe me kualitet më të mirë.

Po ashtu ZRRE konstaton se konsumatori për shkak të rritjes së fuqisë nuk është duke u faturuar sipas rregullave në fuqi përkatësisht konsiderohet se është duke bërë shfrytëzim të pa kontraktuar të energjisë. Sipas Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrik, përkatësisht neni 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.2 thuhet se: *“Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pa kontraktuar nëse: 1.1 Shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë; 1.2. Dështon të zbatojë specifikimet e nxjerra nga ndërmarrja e energjisë dhe nga kodet relevante të cilët aplikohen varësisht nga rasti, në lidhje me vendosjen, funksionimin dhe kyçjen e pajisjes së Konsumatorit, në instalimet elektrike ose të ngrohjes qendrore”*. Po ashtu për shkak të shfrytëzimit të pa kontraktuar të energjisë ndërmarrja e energjisë konform Rregullës për Shkyçjen dhe Rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë, përkatësisht neni 5, ka të drejtë që të bëjë shkyçjen e konsumatorit nga rrjeti elektrik dhe se ri kyçja do të bëhet vetëm nëse plotësohen kushtet teknike të parapara me ofertën e kompanisë për furnizim.

ZRRE për të analizuar sa më saktë lëndën e konsumatorit dhe gjendjen e rrjetit elektrik të asaj pjese, me datë 17.06.2016 ka dalur te konsumatori dhe kanë bërë inqizimin dhe fotografimin e rrjetit ekzistues, si dhe daljes nga është bërë zgjidhja teknike. ZRRE gjatë vizitës në teren ka vërejtur se nga dalja ku furnizohet konsumatori në fjalë janë duke u furnizuar edhe konsumatorë tjerë dhe se për të pasur konsumatori furnizim stabil dhe me kualitet më të lartë, me kapacitetin e instaluar duhet të bëhet investim i propozuar nga KEDS.

ZRRE gjithashtu ka analizuar dokumentet e siguruara nga konsumatori (fotografitë nga terreni) lidhur gjendjen e rrjetit elektrik ekzistues prej nga furnizohet aktualisht konsumatori dhe konsumatorët tjerë në atë dalje, dhe konstaton se gjendja e rrjetit elektrik në atë pjesë nuk është në gjendje të mirë apo në gjendje të kënaqshme. Lidhur me këtë ZRRE konstaton se sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) është përgjegjës për operimin dhe



mirëmbajtjen e rrjetit elektrik. Andaj lidhur me këtë ZRRE kërkon nga KEDS-i që në atë pjesë të rrjetit elektrik ekzistues prej nga aktualisht furnizohet konsumatori me energji elektrike, të përmirësoj rrjetin elektrik, ashtu që konsumatorët tjerë të kyçur në këtë dalje të mos kenë probleme me gjendjen e rrjetit elektrik dhe kualitetin e furnizimit me energji elektrike.

Pas analizimit të të gjitha dëshmive të prezantuara nga palët në kontest dhe Rekomandimin e paraqitur nga DMK, Bordi i ZRRE-së në mbeldhjen e mbajtur me datë 23.06.2016, vendosi që të **refuzoj** ankesën e konsumatorit që KEDS-i të bëjë investojë në rrjetin elektrik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik nr.3904 të datës 22.05.2015.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit A.B (Sh. A. Sh.A),
- KESCO-s, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.